



Titulli i projektit

Terminali i transportit ndërrurban Lezhë

Tipi i projektit

Shërbime vendore

Vendndodhja e projektit

Lezhë

Buxheti i paravlerësuar

300,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Ky projekt synon dizejnimin e një sistemi eficient dhe efektiv të transportit publik, duke përdorur autobusët dhe furgonët dhe infrastrukturën lidhëse me rrejtin rrugor (vendndalimet intermodale dhe sistemin e informacionit të pasagjerëve). Shërbimet e transportit publik do të lidhin Lezhën me qendrat kryesore të Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës; si edhe me rajonin e Lezhës e në veçanti, me destinacionet kryesore turistike (Shëngjin, Shënkoll, Velipojë).

Bashkia Lezhë ka identifikuar tashmë një terren të përshtatshëm për ndërtimin e terminalit të transportit publik, në hyrje të Lezhës, i cili mundëson akses të lehtë nga të gjitha pikat kyçe të rrejtit rrugor. Terreni është në pronësi shtetërore, çka ul kostot e projektit.

Qëllimi/et specifik të projektit


Projekti synon:

- Konceptimin e një sistemi të besueshëm ndërrurban, kryesisht nëpërmjet autobusëve (dhe furgonëve);
- Njohjen e potencialit dhe promovimin e transportit publik nëpërmjet pikave të transferimit në terminal; sistemit të informacionit për pasagjerët;
- Përgatitjen e projektit (skicave) paraprak për vendndodhjen dhe skemën e stacionit terminal.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- Ulje e kostos dhe e kohës së udhëtimit për popullsinë e Zonës Funksionale (66536 banorë); bizneset e zonës; në veçanti ato në sektorin e turizmit;
- Lehtësim i trafikut në nyjet kryesore të qytetit të Lezhës

# PROJEKTI 9



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

- Përshkrimi analitik i shërbimeve aktuale të transportit publik, përfshirë identifikimin e kërkesës;
- Identifikimin e pritshmërive të përdoruesve, nëpërmjet parametrave që influencojnë zgjedhjet e tyre;
- Projeksione për të ardhmen për kërkesën për transport publik dhe konkurrencën nga metoda të tjera, duke pasur parasysh edhe planet për infrastrukturën;
- Një propozim për terminalin, dizajnin dhe kapacitetin;

## Maturimi i projektit

Projekti është në vetvete një studim fizibiliteti, i cili do të ofrojë edhe një koncept paraprak për terminalin, që mund të përdoret për termat e referencës për ndërtimin e projektit.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Aktori më i përshtatshëm për zbatimin e projektit është Bashkia Lezhë dhe/ose në bashkëpunim me donatorë.

## Kostot e projektit

Bazuar në kosto të projekteve të ngjashme, ky Projekt mund të kushtojë rreth 250 000 – 300 000 Euro.